



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **01.08.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Për marrjen në pyetje të personit të arrestuar dhe verifikimit të kushteve dhe nevojave të sigurimit ndaj të hetuarës **Pajtime Fetah**, e dyshuar për veprën penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Atalanta Zeqiraj, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 237 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr.97, datë 02.08.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë.
2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “**arrest në shtëpi**” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj të hetuarës **Pajtime Fetah**, caktuar me vendimin nr.86 datë 29.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 5 (pesë) ditëve, nga e nesërmja e marrjes dijeni lidhur me vendimin e arsyetuar.

Tiranë, më datë 02.08.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar